



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME



Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksksh.com.al

SHPLLJE KONKURIMI I HAPUR PËR VENDET VAKANTE PRANË FONDIT TË
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall konkurimin për pozicionin e punës për:

Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Tiranë;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Berat;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Fier;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Vlorë;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Gjirokastës;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Dibër;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Kukës;
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Fondit, Lezhë;
Kryetar Dege Sarandë.

I. KUSHTET DHE KRITERET E KONKURIMIT

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, apo masa disiplinore për shkelje të rënda në kryerjen e detyrës;
- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë për Juridik, Ekonomik, Mjekësi ose Farmaci, të nivelit minimal "Master Shkencor" si dhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së;
- Nota mesatare do të jetë avantazh;
- Të jetë banor i rrethit ose i qarkut përkatës;
- Të ketë përvojë pune minimumi 3 vjet.

II. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - Letër interesi për pozicionin në të cilin po konkuron;

- Jetëshkrimi i plotësuar (CV);
 - Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - Të paktën 1 referenc nga punëdhënësi apo bashkëpunëtorë të mëparshëm.
 - Diplomë e noterizuar (për diplomat e marra jashtë republikës së shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit);
 - Diplomë Master e noterizuar;
 - Listë notash e noterizuar;
 - Fotokopje të librezës së punës që vërtetojnë eksperiencën në punë;
 - Fotokopje e kartës së indentitetit (ID);
 - Raport mjekësor për aftësi në punë;
 - Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik;
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlersimet positive, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
2. Dokumentacioni i kandidatëve do të dorëzohet pranë drejtorisë së Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në Adresën Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 8, Tiranë
- 3. Dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 27.10.2017**

Kujdes! Mosdorëzimi i dokumentave të mësipërm është kusht skualifikues.

III. FUSHAT E NJOHURIVE PËR TESTIMIN ME SHKRIM

Kandidatët do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË KANDIDATURAVE

Në datën 03.11.2017 kandidatët do të njoftohen nëpërmjet postës elektronike, për informacione në lidhje me plotësimin e kriterëve, fazat e testimit, datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurimi.

1. Vlerësimi i kandidatëve:

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do ti nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

a – Vlerësimin me shkrim, deri në 30 pikë;

b – Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 50 pikë;

Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).

c – Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2. Shpallja e rezultateve të konkurimit:

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit).